



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI I LËNDËS
Tipologji Tekstore e Gjuhës B (2)

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 0 leksione , 40 seminare
Viti / Semestri : Viti II, semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor – “Gjuhë letërsi dhe qytetërim turk”
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Ky kurs ka për qëllim analizën gjuhësore të teksteve të llojeve të ndryshme si, letrare (prozë/poezi), gazetareske (opinione, intervista), ese, etj., me qëllim që studentët të familjarizohen me llojet e ndryshme të teksteve në mënyrë që të jenë në gjendje të shkruajnë tekste të tilla. Lënda zhvillohet në formë seminaresh me diskutime rreth temave të ndryshme, ushtrimeve praktike, materialeve të përfuara nga interneti, etj.

Objektivat specifike lëndore:

1. Ky kurs ka për qëllim analizen gjuhësore të teksteve si dhe analizen e familjeve të ndryshme etimologjike.

Rezultatet e pritshme:

1. Analizojë gjuhësisht tekste të llojeve të ndryshme (letrare, gazetareske, eseistike), duke identifikuar veçoritë e tyre gjuhësore, stilistike dhe funksionale.
2. Zbatojë njohuritë mbi analizën etimologjike, duke ndarë dhe krahasuar fjalë sipas familjeve të ndryshme leksikore dhe origjinës së tyre.
3. Shkruajë në mënyrë të pavarur dhe të strukturuar tekste të ndryshme, duke u bazuar në analizën e modeleve përkatëse dhe duke përdorur gjuhë të saktë dhe të përshtatshme për zhanrin.